Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Sportit dhe Rinisë
Ministarstvo Sporta i Omladine
Ministry of Sport and Youth

CIVIKOS
platforma

Prishtinë, Prill 2025

THIRRJE PËR VOTIM

për përzgjedhjen e përfaqësuesit rinor të Kosovës në Bordin Drejtues të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO)

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) në bashkëpunim me Platforma CiviKos hap thirrjen për votim për përzgjedhjen e përfaqësuesit rinor të Kosovës në Bordin Drejtues të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO).

Përfaqësuesi rinor i Kosovës në Bordin Drejtues të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor do të përzgjidhet nga organizatat e shoqërisë civile, përmes procesit të votimin një organizatë një votë, proces ky që organizohet nga Platforma CiviKos.

Rreth RYCO-s

Në kuadër të Procesit të Berlinit, gjatë Samitit të Ballkanit Perëndimor 2016 në Paris, është nënshkruar Marrëveshja mbi themelimin e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor nga gjashtë vende (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia). Vizioni i RYCO-s është mbështetja e të rinjve si grupi më me interes për të promovuar frymën e pajtimit dhe bashkëpunimit mes të rinjve në rajon përmes programeve të shkëmbimit.

Autoriteti më i lartë për vendimmarrje i RYCO-s është Bordi Drejtues, i përbërë nga dy përfaqësues nga secili vend: një përfaqësues nga qeveria dhe një përfaqësues rinor.

Procesi i votimit

Të drejtë votimi kanë OJQ-të në Republikën e Kosovës. OJQ-të e regjistruara mund të votojnë për kandidatët e tyre të preferuar brenda një afati prej 5 ditësh nga hapja e procesit të votimit. Secila organizatë mund të votojë për një (1) kandidat nga lista e kandidatëve të përfshirë në fletëvotim, sipas parimit ‘një organizatë - një votë’.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Sportit dhe Rinisë
Ministarstvo Sporta i Omladine
Ministry of Sport and Youth

CIVIKOS
platforma

Rikujtojmë se në rastin e votimit të shumëfishtë nga e njëjta organizatë, votat e saj do të konsiderohen të pavlefshme. Gjithashtu, do të konsiderohet e pavlefshme vota e organizatës, e cila nuk ka ngarkuar dokumentacionin si më poshtë ose ka shkelur afatin e votimit.

Votimi do te jetë i hapur nga data **17.04.2026 deri më 23.04.2026 deri në ora 16:00**.

Format e votimit:

Ka tri mënyra që organizatat e regjistruara në Kosovë mund të votojnë:

1. Me email duke dërguar dokumentet te skanuara ne emailin votimi.civikos@gmail.com
2. Fizikisht vetëm me datë 22.04.2026 nga ora 10:00-16:00 Adresa: Platforma CiviKos, Rr. Fazli Grajçevci, Ob.96 - H2 | 10000 Prishtinë Republika e Kosovës.

Dokumentet që duhet të dorëzohen për votim:

1. Fletëvotimi, i plotësuar (të rrethohet numri rendor i kandidatit/es që votoni);
2. Certifikata e regjistrimit të OJQ-së.
3. Deklarata e nënshkruar dhe vulosur nga Drejtori/Drejtoresha e OJQ-së, për votim në këtë proces.

Për të mbikëqyrur procesin e numërimit të votave, Platforma CiviKos do të ftojë në cilësinë e vëzhgueseve përfaqësuesit e MKRS-së dhe të gjitha OShC-të që kanë bërë nominime, rrjetet aktive të shoqërisë civile dhe vëzhgues të intreresuar.

Për çfarëdo pyetje rreth këtij procesi të përzgjedhjes, kontaktoni Platformën CiviKos nëpërmjet e-mailit votimi.civikos@gmail.com

Për më shumë informacion rreth Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor ju lutemi vizitoni https://www.rycowb.org/.

Biografite e kanditateve:

Prezantimi i kandidatëve për përzgjedhjen e përfaqësuesit rinor të Kosovës në Bordin Drejtues të RYCO, e gjeni në këtë link.